

REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC
Kryetari i Kryetarit të Komunës/Kryetari i Kryetarit të Komunës

Njësi Nr./Pr./No 01 Kabineti i Kryetarit të Komunës
Nr. i Reg./Br./str./no pg 95
Data/Date 5 1/23
RAHOVEC / ORAHOVAC

BULETINI GJASHTËMUJOR I AKTIVITETEVE DHE PROJEKTEVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT

Në këtë dokument janë pasqyruar aktivitetet, punët dhe angazhimet e Kryetarit të Komunës dhe drejtorive komunale, të cilat janë realizuar gjatë periudhës korrik- dhjetor 2022, poashtu është prezantuar me fotografi të ndryshme edhe ecuria e realizimit të projekteve kapitale në Komunën e Rahovecit.

BULETINI GJASHTËMUJOR I AKTIVITETEVE DHE PROJEKTEVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT

HYRJE

Të nderuar qytetarë të komunës së Rahovecit,

Kemi kënaqësinë të paraqesim para jush një informatë për punët, angazhimet dhe arritjet e komunës së Rahovecit për periudhën: korrik-dhjetor 2022, si dhe ecurinë e realizimit të projekteve kapitale në komunën e Rahovecit gjatë kësaj periudhe.

Sukseset tona të deritanishme nuk kanë qenë pa sfida dhe pa barriera, e besojmë se sukcesi ynë më i madh i përbashkët ka qenë tejkalimi i sfidave e barrierave në favor të qytetarit rahovecas. Me bashkëpunim të ndërsjellë, me mirëkuptim dhe punë të palodhur, kemi arritur në këtë periudhë që po e lëmë pas, të realizojmë me sukses një sërë projektsh jetike për të ardhmen e Komunës së Rahovecit. Jemi angazhuar fuqishëm të arrijmë nivel më të lartë të transparencës komunale dhe në vazhdimësi jemi përkujdesur që praktikat më të avancuara demokratike, të aplikohen gjatë vendimarrjes në qeverisjen komunale.

Informata që po e prezantojmë sot përfshinë detaje nga këto të arritura dhe suksese të qeverisjes sonë.

KRYETARI I KOMUNËS


Parathënie

Të nderuar qytetarë të
Komunës së Rahovecit,

Qeverisja e mirë nënkupton shërbim ndaj qytetarëve. Komuna e Rahovecit është e përkushtuar që këtë shërbim ta kryej në mënyrën më të mirë të mundshme.

Kryetari Smajl Latifi është zotuar se do t'i çojë deri në fund premtimet e tij për ta ndryshuar jetën e qytetarëve të Komunës së Rahovecit.

"Unë dhe bashkëpunëtorët e mi kemi vetëm një detyrë dhe ajo është që t'iu shërbejmë qytetarëve me dinjitet dhe sa më mirë" – është motoja e qeverisjes sonë.

AKTIVITETE TË RËNDËSISHME GJATË PERIUDHËS KORRIK - DHJETOR 2022

Me drejtorin e Shërbimeve Publike si dhe me disa nga zyrtarët e Drejtorisë për Bujqësi, kryetari ka përcjellur nga afër procesin e korrje – shirjeve në komunën tonë. Bujqit e komunës sonë, përkundër kohës së vështirë, të cilët përballen me rritje çmimesh të farërave, karburanteve e preparateve të nevojshme që nga mbjellja e grurit e deri te korrja, megjithatë po i mbledhin rezultatet e punës së tyre të palodhshme.

Së bashku me drejtorin e Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, me drejtorin e Drejtorisë së Ekonomisë, Zhvillimit dhe Turizmit, si dhe bashkëpunëtorë të tjerë, kryetari ka bërë shpërndarjen e mekanizmave dhe mjeteve bujqësore për 81 bujq. Në fazën e tretë janë shpërndarë 54 spërkatëse, 2 pajisje për mbjelljen e misrit dhe 25 motokultivatorë me frezë 7.5 KW.



Së bashku me përfaqësuesit e organizatës ndërkombëtare ASB (Arbeiter-Samariter-Bund Deutschland), kryetari Latifi ka nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit për financimin e dy projekteve të rëndësishme për komunën tonë, ku hyjnë funksionalizimi dhe rregullimi i hapësirës së jashtme të Qendrës për Qëndrim Ditor për të Moshuarit si dhe furnizimi i OJQ-së "Hareja" me pajisje të teknologjisë së informacionit në vlerë prej 10.000 Euro.

Për nder të "Epopesë së Rahovecit", kryetari Smajl Latifi, së bashku me stafin si dhe në prani të familjarëve, miqve dhe bashkëluftëtarëve, kanë bërë huzëmadhe në të gjitha vendrëniet e dëshmorëve dhe martirëve të luftës, të vrarë nga forcat kriminale serbe.



Në cilësinë e Kryetarit të Komunës së Rahovecit, bashkë me zëvendësministrin e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, z. Hysen Durmishi, është nënshkruar marrëveshje mirëkuptimi për mbështetjen financiare të projektit për asfaltimin e rrugëve në qytet, me vlerë 600,000.00€, si dhe është nënshkruar marrëveshja edhe për përfundimin e financimit të projekteve, për rrugët tashmë të përfunduara: Rahovec - Hamoc - Fortesë si dhe Xërxë - Sapniq - Ratkoc.

Së bashku me Drejtorin e Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale në Republikën e Kosovës, z. Bislim Zogaj, kryetari Smajl Latifi ka nënshkruar marrëveshjen për bashkëfinancimin e projektit: "Memoriali Masakra e Krushës së Madhe - Krushë e Madhe". Ky projekt kap vlerën 82,504.00€, ku Komuna e Rahovecit merr pjesë me 22,504.50€, ndërsa Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale, me 60,000.00€.





Për nder të muajit të mërgimtarëve është organizuar aktiviteti "Ditët e Mërgatës", i cili ka përfshirë aktivitete të ndryshme kulturore, duke filluar me koncerte festive për disa netë me rradhë, ku performan grupe dhe këngëtarë të shumtë.

Kryetari i komunës së Rahovecit, Snajl Latifi, së bashku me drejtorin e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Afrim Dinën, kanë përfunduar hapësirën pushuese e rekreative të "Maja e Shkodranit", në kuadër të projektit "Investime në infrastrukturën kulturore dhe kënde të lojërave", që tashmë kjo hapësirë është gati e do të ofrojë një mundësi argëtimi e socializimi për të gjitha moshat, të cilët kohën e lirë të tyre do të mund ta kalojnë me më shumë lojëra e aktivitete sportive.



Në objektin e SHML "12 Maji" në Ratkoc, kanë filluar punimet e masave të efijencës së energjisë elektrike.

Punimet përfshijnë: riparimin e kulmit, ndërrimi i derve dhe dritareve, instalimi i ndriçimit të brendshëm efficient, izolimi i jashtëm i objektit dhe veprime tjera të nevojshme.

Komuna e Rahovecit në bashkëpunim me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka nënshkruar kontratat me komunën me 10 të rinjtë të komunës sonë, si përfitues nga shtesa e granteve që bashkëfinancohet nga komuna me 15% dhe (MAPL) me 85%. Shuma e përgjithshme që të rinjtë përfitojnë nga kjo skemë, është 118.497 dollarë amerikanë. Ky projekt është donacion nga Qeveria Japoneze, i përkrahur nga Banka Botërore.



Në objektin e shkollës "Skender Kastrati", paralelja e ndarë në Gexhë, kanë filluar punimet në projektin e zbatimit të masave të efijencës së energjisë elektrike. Punimet kanë filluar me riparimin e kulmit e më pas me veprime të tjera.

Në cilësinë e kryetarit të komunës së Rahovecit e në prani të ambasadorit të SHBA-së në Prishtinë, Jeff Hovenier, është nënshkruar Memorandumi i bashkëpunimit me USAID për projektin: "Integriteti i Komunave në Kosovë", ku në mesin e tetë komunave të tjera është edhe Komuna e Rahovecit. Projekti përfshin: mbikëqyrjen e financave publike, sundimin e ligjit, transparencën, llogaridhënien, efijencën, efektshmërinë, reagueshmërinë, përfshirjen dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në këtë proces si dhe menaxhimin e kontratave të prokurimit.





Kryetari Latifi së bashku me z. Visar Hasi, U.D i KRU "Gjakova", ka nënshkruar marrëveshjen për bashkëfinancimin e projektit për rehabilitimin e rrjeteve të ujësjellësit në fshatrat Ratkoc, Bratotin dhe Vrajakë.

Vlera e projektit është 61,000.00 €, nga të cilat Komuna e Rahovecit do të financojë 49% të mjeteve, ndërkaj KRU "Gjakova" 51%.

Së bashku me ministrin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, z. Elbert Krasniqi, kryetari Smajl Latifi ka nënshkruar marrëveshjen për mbështetjen financiare të projektit "Trajtimi i Vlerave të Trashëgimisë Kulturore dhe Krijimi i Sigurisë së Lëvizjes në Qytetin e Rahovecit", projekt që kap vlerën prej 174.519.05 €, nga të cilat ministria do të merr pjesë në financim me 100.000 €, ndërsa Komuna e Rahovecit me 74.519.05 €.



Në sallën e Kuvendit Komunal është mbajtur mbledhja e rregullt e kuvendit, ku në rend dite ishin këto pika:

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar, pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve, shqyrtimi i Raportit financiar janar – qershor – 2022, shqyrtimi i Raportit të punës së DKA-së për përfundimin e vitit mësimor 2021/2022, shqyrtimi i Raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të komunës së Rahovecit për vitin 2021.



Rahoveci është renditur Komuna më transparente në Republikën e Kosovës, për periudhën janar – qershor 2022, nga “Aleanca Qytetare për Transparencë”, e përbërë nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), UOIF PALME INTERNATIONAL CENTER - KOSOVO PROGRAM si dhe 9 organizatat e tjera partnere.

Bazuar në vlerësimin e bërë për 38 komunat e Republikës së Kosovës, Rahoveci për gjashtëmuajorin e parë të këtij viti ka arritur nivelin më të lartë në përbushjen e indikatorëve vlerësues me 83 pikë apo 94.32.

Komunitetet i tërë bashkë me pikë të marrëshme - Janar - Qershor 2022 / 2022																
nr. i bashkisë	Emri i bashkisë	2022		2021		2020		2019		2018		2017		2016		Pjesëtarë / Bashkues
		Pjesëtarë	Pjesëtarë / Bashkues	Pjesëtarë	Pjesëtarë / Bashkues	Pjesëtarë	Pjesëtarë / Bashkues	Pjesëtarë	Pjesëtarë / Bashkues	Pjesëtarë	Pjesëtarë / Bashkues	Pjesëtarë	Pjesëtarë / Bashkues			
1	Blinishtica	271	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
2	Blinishtica	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
3	Blinishtica	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
4	Blinishtica	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
5	Blinishtica	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
6	Blinishtica	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
7	Blinishtica	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
8	Blinishtica	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
9	Blinishtica	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
10	Blinishtica	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
11	Blinishtica	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
12	Blinishtica	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
13	Blinishtica	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
14	Blinishtica	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
15	Blinishtica	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
16	Blinishtica	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
17	Blinishtica	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
18	Blinishtica	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
19	Blinishtica	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
20	Blinishtica	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
21	Blinishtica	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
22	Blinishtica	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
23	Blinishtica	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
24	Blinishtica	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
25	Blinishtica	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
26	Blinishtica	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
27	Blinishtica	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
28	Blinishtica	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
29	Blinishtica	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
30	Blinishtica	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
31	Blinishtica	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
32	Blinishtica	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
33	Blinishtica	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
34	Blinishtica	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
35	Blinishtica	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
36	Blinishtica	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
37	Blinishtica	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
38	Blinishtica	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
39	Blinishtica	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
40	Blinishtica	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
41	Blinishtica	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
42	Blinishtica	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
43	Blinishtica	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
44	Blinishtica	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
45	Blinishtica	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
46	Blinishtica	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
47	Blinishtica	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
48	Blinishtica	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
49	Blinishtica	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
50	Blinishtica	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	

Së bashku me drejtorin Berat Duka si dhe me zyrtarët e Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, kryetari Smajl Latifi ka bërë shpërndarjen e pajisjeve bujqësore për 38 bujq përfitues. Mekanizmat që janë ndarë në këtë fazë janë: 27 motokultivatorë me frezë 7.5 KW, 3 spërkatëse 500 L, 8 motokosa dhe 1 mbledhëse e brit (grabujë).



Kryetari Latifi së bashku me drejtorin e Shërbimeve Publike Përparim Krasniqi, në prani të qytetarëve është përfunduar ndriqimin publik në Brestoc dhe Hoçë të Vogël, në gjatësi prej 3.4 kilometra në rrugën kryesore që lidh dy fshatrat.



Komuna e Rahovecit me mbështetje të CARITAS Switzerland & GERMIN, përmes projektit "Veprimi i Komunave për Riintegrim dhe Diasporë - MARDI", ka organizuar për herë të parë në formatin B2B takimin me rreth 30 biznese të Diasporës dhe ato vendore në Rahovec, me qëllim të rrjetëzimit dhe krijimit të partneriteteve të reja.





Nën organizimin e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Komuna e Rahovecit mbajti dëgjimin publik buxhetor me organizatat joqeveritare që veprojnë në komunën e Rahovecit, ku janë parashtruar kërkesat e tyre.


Drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural së bashku me stafin e tij, kanë vizituar punimet që po zhvillohen te kanali i kullimit të tokave bujqësore në Rahovec dhe Fortesë, me gjatësi prej 5 km.



Angazhimet për mirëmbajtjen e hapësirave publike kanë vazhduar në: varreza civile, lapidare dhe vend-rëniet e dëshmorëve, varreza të dëshmorëve, mjediset përreth objekteve të gjendjes civile dhe të QMF dhe AMF në fshatrat Xërxë, Krushë e Madhe, Drenoc, Pastasel, Opterushë, Zoqisht, Retijë, Retijë e Ulët dhe Brestoc.



Kryetari Smajl Latifi, së bashku me bashkëpunëtorë, morën pjesë në përfundimin e fillimit të projektit: "Ndërtimi i Sheshit në Qendër të Qytetit". Projekti bashkëfinancohet nga Komuna e Rahovecit dhe Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe kap vlerën: 155,959.00 €, ku komuna e Rahovecit merr pjesë me 80,959.00€, ndërsa MZHR me 75,000.00€. Projekti parasheh, platonë me fontanë të rrafshët, ulëse, ndriçim të ulët, drunj dekorues dhe elemente të tjera përcjellëse që do t'i japin pamje të bukur dhe funksionale qendrës së qytetit.




Kryetari Smajl Latifi, së bashku me stafin e tij, kanë përfunduar ndriçimin publik në segmentin e unazës në qytet prej 650 metra (30 drita), si pjesë e projektit të ndërtimit të rrugës Rahovec - Hamoc - Fortesë. Ky segment rrugor, përveç sigurisë, krijon edhe qasje të mirë për të gjithë qytetarët që lëvizin gjatë mbrëmjes dhe e shfrytëzojnë këtë rrugë në formë shtegu. Përfundimi i ndriçimit publik i cili lidh rrugën "Mexhit Mustafa" e të shpie kah Veraria "Kosova Wine" dhe lidhet me rrugën "Vëllezërit Haradinaj".



Në sallën e mbledhjeve të Kuvendit Komunal u mbajt konsultimi publik për Planin e Menaxhimit të Mbeturinave 2021-2024.

Takimin e kryesoi Drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike, z. Përparim Krasniqi, i cili para pjesëmarrësve në konsultim prezantoi në pika të shkurtra Planin e Menaxhimit të Mbeturinave për komunën e Rahovecit, objektivat, strategjinë e procesit të hartimit dhe implementimit të tij.

Në sallën e mbledhjeve të Kuvendit Komunal të Rahovecit, dhe është mbajtur mbledhja e pestë e radhës e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKS). Sa i përket vlerësimit të përgjithshëm të gjendjes së sigurisë në territorin e komunës së Rahovecit, kryetari latifi është shprehur se situata në gjithë territorin e komunës është e qetë dhe stabile, duke u bazuar në raportet policore si dhe institucionet relevante.



Kryetari Smajl Latifi së bashku me bashkëpunëtorët e tij, ka mbajtur takim me Këshillin Organizativ të festivalit "Hardh Fest". Festivali që i kushtohet Festës së Vjeljes së Rrushit në komunën tonë, është kthyer pas dy viteve ndërprerje për shkak të krizës nga pandemia, dhe është një prej ngjarjeve më të rëndësishme kulturore në Kosovë, rajon dhe po depërton e njihet edhe në Evropë e më larg, duke promovuar vreshtarinë dhe kulturat tjera bujqësore, por dhe punën e palodhshme e fisnike të bujqve rahovecianë, drejtuesve dhe organizatorëve të festivalit.

Kryesuar nga kryesuesi i Kuvendit, Defrim Kafexhiu, është mbajtur mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit. Në rend dite ishin këto pika:

Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve nga Raporti i Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin 2021, vendimi për formimin e komisionit për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve, rrugicave, parqeve, shesheve dhe lagjeve në komunën e Rahovecit, vendimi për shpallje me interes të përgjithshëm publik pjesën e P-71510057-0234-2 në zonën kadastrale Rahovec, vendimi për



dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim personave fizik dhe juridik P- 71510057-05864-0 zona, në kadastrale Rahovec, vendimi për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale P- 71510057-05864-0 zona, në kadastrale Rahovec, vendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim personave fizik dhe juridik P- 71510021-00010-1 dhe P-71510021-00010-2, në zona kadastrale Dobidol, vendimi për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale P- 71510021-00010-1 dhe P-71510021-00010-2, në zona kadastrale Dobidol, vendimi për shfuqizimin e vendimit 01 Nr.337/22, i datës: 29.06.2022 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës, vendimi për shfuqizimin e vendimit 01 Nr.339/22, i datës: 29.06.2022 për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale.



Në Ditën Ndërkombëtare të të zhdukurve me dhunë, kryetari Latifi së bashku me stafin e tij, kujtuan dhe nderuan njerëzit tanë, që edhe pas 23 vjetësh ende janë të pagjetur. Në ditën kur bota kujton personat e zhdukur, Komuna e Rahovecit kujton 103 të pagjetur, ku 64 të pagjetur janë vetëm në Krushë të Madhe, pa harruar edhe profesorin dhe politologun e shquar, Ukshin Hoti.

Direktori për Buxhet dhe Financa z. Afrim Limani, sipas afatit ligjor zyrtarisht e dorëzoi dokumentin e propozim-buxhetit për vitin 2023-2025 kryesuesit të Kuvendit Komunal të Komunës së Rahovecit, z. Defrim Kafexhiu. Në buxhetin e vitit 2023 janë përfshirë edhe një numër i konsiderueshëm i projekteve të rëndësishme për Komunën e Rahovecit, kërkesa dhe propozime të bëra nga qytetarët gjatë dëgjimeve buxhetore që janë mbajtur në qytet dhe në të gjitha fshatrat.



Në 24 vjetorin e betejës për Zatriqin dhe në Dobidol, kryetari Latifi, së bashku me bashkëpunëtorët e tij, si dhe me përfaqësuesit e OVL-UÇK, në prani të familjarëve, bashkëluftëtarëve dhe miqve, bëri homazhe në nderim të kujtimit për dëshmorët dhe martirët e rënë Mazllum Kastrati, Xhafer Vehapi, Esat Kastrati si dhe Mark Sopjani. Homazhe janë bërë edhe në Polluzhënë nderim të dëshmorëve Shani Hoti dhe Afrim Bajraktari.



Me datat 2, 3 dhe 4 shtator, në Rahovec është mbajtur Festivali i Vjeljes së Rrushit "Hardh Fest", ku qytetarë nga mbarë Kosova dhe jashtë saj, u kënaqën me aktivitete të shumta ditore dhe koncertt e tri netëve që kishin përgatitur për sivjet organizuesit e festivalit.





Kryetari Latifi priti në vizitë një grup studentësh të shoqëruar nga profesorët e Fakultetit të Bujqësisë në Universitetin Giessen nga Gjermania Rainer dhe Till, si dhe profesorin Arben Mehmeti nga Fakulteti i Bujqësisë i Universitetit të Prishtinës, të cilët gjatë qëndrimit në Kosovë, patën mundësi të vizitonin Qendrën Grumbulluese të Pemëve dhe Perimeve "Agro Celina", kompaninë "Stone Castle" si dhe disa kompani tjera në komunën tonë.

Kryetari Latifi, së bashku me drejtorin e DSHP-së, Përparim Krasniqi, pritën në takim delegacionin nga Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave, z. Shpend Terdeva, Drejtori i DSSH-së, z. Kastriot Lajçi, Kryeinspektor në MPB-AME, z. Valon Krasniqi, Drejtori i OZSH-së dhe z. Dardan Lushtaku, Zyrtar i Financave në AME, ku diskutuan për projekt-planin komunal për vlerësimin e rreziqeve nga fatkeqësitë elementare natyrore dhe të tjera, planet operative të zjarrfikësve, nevojën për shtimin e personelit të zjarrfikësve, projektligjin e ri të AME, angazhimin e inspektoratit për parandalimin e ndërtimeve pa leje.



Në Palestrën Sportive "Mizahir Isma" në Rahovec, është bërë fillimi i Kampionatit të Basketbollit në Superligën e Kosovës, në një atmosferë të bukur dhe të zjarrtë, ku KB "Rahoveci" ka luajtur kundër KB "Golden Eagle Ylli".

Kryetari Latifi, nënkryetari Fatmir Iska, drejtoresha e DSHPS-së Saranda Salteku dhe drejtori i QKMF-së "Dr. Fahredin Hoti", dr. Elbunit Kryeziu, kanë mbajtur takim me stafin shëndetësor, me të cilët diskutuan përsituatën pandemike, kapacitetet shëndetësore, shërbimet e ofruara dhe kushtet e punës në këtë institucion, investimet në objektin e vjetër të QKMF-së dhe planet për të ardhmen.



Së bashku me drejtorin e DKRS-së, z. Afrim Dinën, kryetari Latifi, në prani të kryetarit të fshatit z. Mirsad Qehaja si dhe qytetarëve të Retisë së Ulët, përruan mjediset e reja sportive për futboll, basketboll dhe volejboll, që do të shërbejnë për sport dhe rekreacion për qytetarët e fshatit.

Është kompletuar shpërndarja e paisjeve për bujqit përfitues, ku edhe 40 bujq kanë pranuar pajisje bujqësore:

- 30 frezë 1.8 m – për 30 bujq
- 2 frezë 1.6 m – për 2 bujq dhe
- 8 mulqere për hardhi – për 8 bujq.




Spasojë e reshjeve të shumta të shiut, Komuna e Rahovecit, është goditur rëndë nga vërshimet dhe përmbytjet në orët e hershme të mëngjesit, ku menjëherë është formuar dhe Shtabi Emergjent. Zonat më të prekura ishin: Fortesë, Sapniq, Ratkoc, Malësi e Vogël, Gexhë, Celinë, Xërxë, Dejnë, Krushë e Madhe, Nagac, Çifllak, Hoqë e Vogël, Dobidol, etj. Drejtoria e Shërbimeve Publike me Njësinë e Zjarrfikësve, Drejtoria e Bujqësisë, Stacioni Policor Rahovec, kompanitë e kontraktuara nga komuna si dhe ekipet vullnetare, kanë punuar pandërprerë, në mbrojtje të qytetarëve dhe pronave të tyre, si dhe në sanimin e pasojave.



Kryetari Latifi, priti në takim ministrin e MPB-së, z. Xhelal Sveqla, ministrin e MAPL-së, z. Elbert Krasniqi, ministrin e Ministrisë së Mbrojtjes, z. Armend Mehaj, zëvendësministrin e bujqësisë z. Imer Demelezi, si dhe drejtorin e AME, z. Shefki Avdullahu, me të cilët nga afër vizituan zonat e prekura nga vërshimet dhe përmbytjet e datës 17.09. 2022.



Bashku me bashkëpunëtorët e tij, kryetari Latifi, në prani të familjarëve, miqve dhe bashkëlloftëtarëve, bëri homazhe për nder të 22 vjetorit të rënies së komandantit Shender Gashi, si dhe dëshmorëve Shkelzen Krasniqi, Betim Berisha dhe Eqrem Hoxha.



Kryetari Latifi ka mirëpritur në takim komandantin e KFOR-it italian për Rajonin Perëndimor, z. Ivano Marotta, me të cilin diskutuan për projektet që janë duke u zhvilluar në Komunën e Rahovecit, situatën e sigurisë, investimet që po bëhen si dhe për aktivitetet komunale.

Kryetari Latifi ka pritur në takim ministrin e MKRS-së, z. Hajrulla Çeku, me bashkëpunëtorët e tij, ku diskutuan për ç'bllokimin e projektve të cilat ka kohë që presin, sikur se janë memorandumet e nënshkruara në vitin 2019, si dhe për projektet e reja për komunën tonë. Po ashtu, kryetari kërkoi nga ministri përkrahjen e tij për projektet nga fusha e trashëgimisë kulturore, rinisë dhe investime në infrastrukturën sportive.





Kryetari Latifi ka mirëpritur në takim znj. Jennifer Ober, drejtoreshë e aktivitetit të USAID-it dhe z. Ramadan Klisurica, përfaqësues i projektit "Qeverisja e Pronës", të cilët diskutuan për realizimin e këtij projekti, ku fokusi kryesor do jetë në ofrimin e shërbimeve më të mira pronësore nga ana e komunës, pjesëmarrja e grave dhe avancimi i rolit të gruas në prona, si dhe roli i bizneseve në çështjet pronësore.

Në mbledhjen e nëntë të rregullt të Kuvendit Komunal të Rahovecit, është miratuar buxheti për vitin fiskal 2023. Ky buxhet vjen pas konsultimeve të mbajtura me qytetarë, biznese, shoqërië civile, fermerë, pas dëgjimeve buxhetore e vlerësimeve nga profesionistë të të gjitha fushave, i cili kap vlerën prej 17,548,240.00 €.



Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport ka filluar punimet në realizimin e rregullimit të parkut në fshatin Nagavc. Ky projekt parasheh një hapësirë të re gjelbëruese dhe relaksuese për të gjitha grupmoshat.

Kryetari Latifi ka mbajtur takim me ministrin e MINT-it, znj. Rozeta Hajdari, ku bashkëbiseduan për investimet në Zonën Ekonomike - Parkun Industrial në Opterushë, me të cilën ministrja Hajdari konfirmoi se kjo ministri do të financojë projektin me 1.5 milionë €, kurse komuna e Rahovecit me 300 mijë €, në total investimi kap vlerën 1.8 milionë €.



Kryetari Latifi, ka pritur në takim zyrtarë nga USAID, në krye me drejtoreshën Jennifer Ober dhe kanë nënshkruar Memorandumin e Mirëkuptimit në mes të Tetra Tech ARD, zbatues i aktivitetit USAID Kosovo – Qeverisja e Pronës dhe Komunës së Rahovecit, në lidhje me zbatimin e përbashkët të projektit “Qeverisja e Pronës”.

Në një vizitë miqësore, kryetari Latifi e ka mirëpritur ambasadorin e Austrisë në Republikën e Kosovës, z. Christoph Weidinger, z. Karl Wilfing, Kryetar i Kuvendit të Austrisë së Ulët, z. Karl Moser, Nënkryetar i Kuvendit të Austrisë së Ulët, me bashkëpunëtorët e tyre. Në këtë takim kryetari e informoi ambasadorin me aktivitetet dhe planet e komunës së Rahovecit, si dhe e falenderoi për mbështetjen dhe bashkëpunimin e dhënë.





Pjesëtarëve të Gardës Kombëtare me kuadrot profesionale xheniere, OR-6 Fitim Zullufi, OR-6 Naim Beka, OR-5 Hazir Murturi, OR-4 Epror Bytyqi, kryetari Latifi u ka ndarë mirënjohje, të cilët me përkushtim të madh, kanë bërë një punë jashtëzakonisht të mirë me dy eskavatorë për pastrimin e shtratit të lumit Bellaja deri te hekurudha, në të cilin derdhen tre përrenj: Duhlllo, Rimniku dhe përroi që vjen nga Sapniqi, si rezultat i përmbytjeve, ku gjithsej janë pastruar dhe rregulluar 1380 metra.

Kryetari i Komunës, z. Smajl Latifi, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me znj. Vlora Elshani përfaqësuese nga ReLOaD2 - Programi për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP), përmes të cilit program synohet forcimi i kapaciteteve të komunës dhe rritja e bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile në nivel lokal. Përmes kësaj marrëveshjeje do të angazhohen pesë praktikantë me pagesë për gjashtë muaj në institucione publike dhe OJQ.



Kryetari Smajl Latifi, së bashku me stafin e tij, është mirëpritur në takim nga Kryebashkiaku i kryeqendrës së shqiptarëve - Tiranës, Erion Veliaj me bashkëpunëtorë, për të hapur shtigjet e punëve të përbashkëta në të ardhmen. Pas shkëmbimit të përvojave dhe ideve, u dakorduan për bashkëpunim institucional në fushën e bujqësisë, ekonomisë, turizmit, rinisë e sportit, si dhe në zhvillimin e agro-turizmit, mundësi të jashtëzakonshme këto, me dobi të drejtpërdrejta mes nesh.

Qendra e Mjekësisë Familjare “Dr. Fahredin Hoti” në Rahovec, ka përfituar një Grant të Performancës nga AQH në vlerën prej 20 mijë €, në pajisje për Sektorin e Urgjencës.

Granti përfitues përfshin:


- 2 monitorë
- 1 defibrilatorë manual
- 3 defibrilatorë automatik
- 2 shtretër për reanimim dhe
- 1 orman për barna emergjente.



Kryetari i Komunës Smajl Latifi, ka publikuar raportet e komisionit për vlerësimin e dëmeve në Komunën e Rahovecit në vlerë totale prej 3, 546,477.66 €. Këto dëme janë shkaktuar si pasojë e të reshurave të mëdha të shiut, më 17 shtator të këtij viti, ku komuna e Rahovecit është goditur në masë të madhe nga përmbytjet si në: shtëpi banimi, ekonomi familjare, biznese, hapësira dhe objekte publike, bujqësi etj.

PUNËSIMI E PËRVEKËSIMI TË DËMEVE			
Kategoria e dëmit		Vlera e dëmit	
1	Dëmet në sektorin e punëve kulturore	1,692,153.05 €	
2	Dëmet në sektorin e lartëvlerës	15,085.50 €	
3	Dëmet në sektorin e bagëtitë të depozuar	9,656.00 €	
4	Dëmet në infrastrukturën bujqësore	8,357.20 €	
5	Dëmet në produkte të gatshme	7,202.90 €	
6	Dëmet në sektorin e shpërndarjes dhe bletarisë	1,300.00 €	
TOTAL		1,735,854.65 €	

PUNËSIMI E PËRVEKËSIMI TË DËMEVE		
Kategoria e dëmit		Vlera e dëmit
1	Dëmet në sektorin e punëve kulturore	1,692,153.05 €
2	Dëmet në sektorin e lartëvlerës	15,085.50 €
3	Dëmet në sektorin e bagëtitë të depozuar	9,656.00 €
4	Dëmet në infrastrukturën bujqësore	8,357.20 €
5	Dëmet në produkte të gatshme	7,202.90 €
6	Dëmet në sektorin e shpërndarjes dhe bletarisë	1,300.00 €
TOTAL		1,735,854.65 €



Kryetari Latifi së bashku me stafin e tij, morën pjesë në fillimin e punimeve për realizimin e projektit “Sheshi i Republikës”, i cili është bashkëfinansim nga MAPL dhe komuna e jonë. Projekti parasheh: sheshin e shtruar me gurë (kalldrëm), ndriçimin publik, gjelbrimin, ndërrimin e gypave të ujësjellësit, ulëse, një rrugë me gurë (kalldrëm) dhe elemente që i shtojnë vlerat historike dhe të trashëgimisë, funksionalitetin më të mirë dhe bukurinë kësaj pjese të vjetër të qytetit.

Kryetari Latifi së bashku me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, z. Liburn Aliu, kanë nënshkruar një aneks memorandum mirëkuptimi për vazhdimin e bashkëfinancimit të projektit: "Rregullimi i shtretërve të lumenjve në fshatrat Hoçë e Madhe, Brestoc, Hoçë e Vogël, Nagac dhe Krushë e Madhe". Me anë të kësaj marrëveshje, MMPHI, për këtë vit do të sigurojë mjete në vlerë prej: 60,000€ për realizimin e këtij projekti.



Në kuadër të zbatimit të masave të efijencës së energjisë në objekte shkollore, punimet kanë vazhduar në izolimin e jashtëm dhe montimin e dritareve të reja termoizoluese në Shkollën e Mesme të Lartë "12 Maji" në Ratkoc.

Në kuadër të fushatës "Tetori Rozë", nën organizimin e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, në ambientet e QKMF "Dr. Fahredin Hoti" u mbajt ligjëratë ndërgjegjësimi kundër kancerit të gjirit, e udhëhequr nga kirurgu torakal Dr. Selajdin Bajrami, i cili shpjegoi për simptomat, trajtimin dhe rreziqet që paraqet kanceri i gjirit, gjithmonë duke bërë thirrje që vetëkontrolli dhe vizita mjekësore e hershme shpëton jetë.





Kryetari Latifi, në prani të menaxherit të prokurimit, drejtorit të arsimit dhe përfaqësuesve të kompanisë NPN "EUROING" SH.P.K, kanë nënshkruar kontratën për projektin "NDËRTIMI I OBJEKTIT TË SHFMU "HAMËZ THAÇI" NË XËRXË, me vlerë 1,575,678.59€. Ky është një projekt i ri dhe shumë i nevojshëm për nxënësit dhe mësimdhënësit e Xërxës, i cili do të jetë me standarde bashkëkohore, me të gjitha kushtet moderne infrastrukture.

Kryetari Smajl Latifi, së bashku me drejtorin e DKRS Afrim Dinën, drejtorin e DPZHR Berat Durakun, po ashtu edhe me inxhinierët përgjegjës Sylejman Daka nga komuna, arkitektin Arbër Zenuni nga Krusha e Madhe si dhe inxhinierin Arianit Termkolli nga kompania zbatuese "Sinani ing", si dhe me udhëheqësin e ansamblit "Bajram Curri" Fatmir Sejfullahu e pjesëmarrës të tjerë, kanë vendosur gurthemelin e projektit për ndërtimin e aneksit në bibliotekën në Krushë të Madhe, që kap vlerën prej 96,753.61 €.



Në prani të drejtorit të DSHP, Përparim Kryeziut, si dhe në prani të grupit punues, u mbajt konsultimi publik për planin e vlerësimit të rrezikut në komunën e Rahovecit. Ky plan u përgatit nga grupi punues dhe nga ekspert të Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave në nivel nacional, i cili ka qenë në konsultim publik nga data 7 tetor deri më 7 nëntor 2022.

kyesuar nga kryesuesi i Kuvendit
Dëfrim Kafexhiu, është mbajtur
mbledhja e rregullt e Kuvendit
komunal të Rahovecit. Gjatë kësaj
mbledhje janë shqyrtuar 10 pika dhe
pënjë marrë këto vendime.



Nënkryetari i komunës, z. Fatmir Iska
dhe drejtori i Bujqësisë, z. Berat Duraku,
së bashku me bashkëpunëtorë,
përcollën nga afër punimet që po
zhvillohen në ndërtimin e kanalit të
kullimit dhe drenazimit të tokave
bujqësore në mes të fshatrave Celinë
dhe Fortesë, i cili projekt përmban tre
segmente me gypa betoni që shërbejnë
për evakuim të ujërave të tepërta, si dhe
katër segmente për kullim të ujërave.

Në kuadër të memorandumit të mirëkuptimit të nënshkruar me ASB-në, kryetari Latifi
në prani të bashkëpunëtorëve dhe përfaqësuesve të organizatës, ka bërë pranimin e
pajisjeve rekreative për plotësimin sa më të mirë të kushteve në shtëpinë për të
moshuar me qëndrim ditor, si dhe pajisje për kushte më të mira në SHPG "Hareja" në
vlerën 10.000€, ku 7.000€ janë financuar nga organizata humanitare gjermane (ASB)
dhe 3.000€ nga komuna e Rahovecit.



Kryetari Latifi, së bashku me drejtorin e
drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Afrim
Dina, në prani të qytetarëve, kanë përfunduar
fushën sportive në Celinë. Fusha sportive i
plotëson kushtet e përshtatshme, si dhe
është e një cilësie të mirë për të luajtur
futboll, basketboll dhe volejbol, aktivitetet
këto shumë të nevojshme për shëndetin,
edukimin dhe kalitjen fizike të të rinjve tanë.

Në prani të nxënësve, mësimeve, drejtorit të arsimit dhe shumë qytetarëve të Xërxës, ka nisur së zbatuari projekti për ndërtimin e objektit të ri të ShFMU "Hamëz Thaçi". Vënia e gurthemelit, që simbolizon nisjen e punimeve është rezultat i angazhimit dhe përkushtimit tonë për të realizuar investime, që janë në funksion të ofrimit të kushteve dhe standardeve sa më bashkëkohore për mësime dhe mësime cilësore.



Kryetari Latifi, së bashku me drejtoreshën për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale Saranda Salltekun, kanë nënshkruar kontratat për përkrahje financiare të projekteve të SHPG "Hareja" dhe të OJQ "Handikos".

Kryetari Latifi, së bashku me drejtorin e BPZHR – së, Berat Durakun, si dhe me stafin e tij, vënë gurthemelin për fillimin e punimeve në projektin për "Ndërtimin e Qendrës për Magazinimin dhe Ruajtjen e Prodhimeve Bujqësore (Deposë Bujqësore). Kjo depo do të ketë 7 dhoma ftohëse, ku 3 prej tyre do jenë edhe me ngrirje të thellë dhe energjia për to do të sigurohet edhe nga panelet diellore. Projektin kap vlerë prej 424,397.00 €.



Në 24 vjetorin e rënies në përballje me forcat pushtuese serbe, kryetari Smajl Latifi, së bashku me stafin e tij bënë homazhe në nderim të kujtimit dhe vdeprës së pavdekshme ndër breza të heronjve Xhelal Hajda - Toni, Selajdin Mullabazi - Mici nga Rahoveci, si dhe Hamdi Hajrizi, Bektesh Haliti dhe Nezir Ymeri nga Vushtrria.



Kryetari i komunës ka nënshkruar edhe një kontratë shumë të rëndësishme për arsimin në komunën tonë, për projektin "Ndërtimi i aneksit të SHFMU "KATËR DËSHMORËT" në Ratkoc". Ky aneks shkollor do të përmbajë në vete 14 dhoma mësimi (klasa), sallën e arsimtarëve dhe hapësirat tjera, do të bëhet e mundshme që nxënësit e kësaj shkolle të mbajnë mësim në një ndërrim të vetëm. Vlera e projektit është 899.991,89 €.

Kryetari i Komunës, z. Smajl Latifi, ka pritur në takim pune, Drejtorin e KRU "Radoniqi - Dukagjini", z. Jahja Kadrija së bashku me përfaqësues të projektit të ARDP- së, të financuar përmes kredisë nga Banka Botërore dhe zbatohet nga MBPZHR, znj. Arlinda Arenliu, drejtoreshë e projektit, z. Avdullah Nishori, specialist i ujitjes, znj. Laura Gjakova - ARDP dhe z. Bali lestrani - MBPZHR, të cilët paraqitën planin e investimeve për fazën e dytë në sistemin aktual të ujitjes, e cila përfshin vendbanime dhe zona që nuk janë të parapara në sistemin ekzistues të ujitjes. Investimi do të kap vlerën gjithsej 10 milionë €, pra, projekti është vazhdimësi e shumës 4.2 milionë €, e filluar vite më parë.



Kryetari Latifi, në prani të bashkëpunëtorëve, të SHL – Kosova, LMT-së si dhe qytetarëve prezentë, ka bërë prezantimin e projektit Harta Turistike e Rahovecit dhe Harta e Trashëgimisë Kulturore me QR CODE "RAHOVECI DIGJITAL", i cili është projekti i radhës i zhvilluar nga Komuna e Rahovecit, tejet i nevojshëm për orientimin e vizitorëve të huaj në Rahovec dhe mundësi e promovimit të potencialit tonë turistik, të trashëgimisë kulturore dhe historike dhe vlerave të tjera.



Kryetari Latifi, ka nënshkruar kontratën për rregullimin e infrastrukturës publike, në vlerë prej 1,222,222.00 €, e cila kontratë është në bashkëfinancim mes MMPHI-së dhe Komunës së Rahovecit, ku përfshihet ndërtimi i rrugëve: Ali Sokoli; Fahredin Hoxha; Dëshmorët e Pashtrikut; Xhelal Hajda - Toni; Gzim Hamza – Piktori dhe Shejh Mihedini. Këto rrugë do të trajtohen me infrastrukturë publike nëntokësore, kanalizim fekal dhe atmosferik, kablo nëntokësore aty ku mungojnë, trotuare, ndriçim publik, asfaltim të tërësishëm si dhe kanale për trajtim të ujit dhe devijimi i lumit Duhlllo.

Në prag të 28 Nëntorit - Festës sonë të madhe kombëtare, kryetari Latifi së bashku me bashkëpunëtorët e tij, si dhe në prani të qytetarëve, përuroi objektin e ri të Shkollës Filllore të Mesme të Ulët "Haki Stërmilli", paralelja e ndarë në Retijë, projekt ky i financuar dhe i realizuar nga komuna jonë. Ky objekt shkolle është një objekt të ri, modern, me kushte shumë të mira dhe standarde bashkëkohore për të zhvilluar proces mësimor cilësor.



Në sallën e Kuvendit Komunal, është mbajtur konsultimi publik për Projekt Planin e punës së Kryetarit dhe ekzekutivit për vitin 2023. Shefi i Kabinetit, z. Ali Morina prezantoi në pika të shkurtëra Projekt Planin, synimet dhe prioritet kryesore të vitit 2023, ku ndër të tjera tha se Komuna e Rahovecit dhe Qeveria Komunale, prezanton planin e saj qeverisës për vitin 2023, duke e bërë një studim të detajuar të të arriturve, por edhe nevojave dhe pritjeve të qytetarëve nga Komuna e Rahovecit për të ardhmen.

Në rastin e 28 Nëntorit – Ditës së pavarësisë së Shqipërisë, Drejtoria për Kulturë, Rinë dhe Sport, organizoi aktivitetet kulturore të shumta si dhe koncertin festiv, ku present ishin asamblet nga Shkupi dhe Krusha e Madhe. Manifestimi është mbajtur në palestrën sportive “Mizahir Isma” në Rahovec.



I shoqëruar nga drejtori i DKRS - së, z. Afrim Dina, Kryetari Latifi priti në takim kryetarin e FFK-së, z. Agim Ademi dhe drejtuesit e “KF Rahoveci”, me të cilët u pajtuan që në stadiumin “Jahja Danuza”, të bëhen disa intervenime emergjente. Me z. Ademi u morëm vesh edhe për projekte të përbashkëta që do të realizohen shpejtë dhe klubeve tona do t’u ofrohet mundësi më e mirë e zhvillimit të garave në ligat në të cilat garojnë.

Kryetari Latifi së bashku me nënkryetarin z. Fatmir Iska, kanë marrë pjesë në fillimin e ndërhyrjeve të nevojshme për përmirësimin e kushteve në fushën e stadiumit aktual të qytetit të Rahovecit, “JAHJA DANUZA”, në mënyrë që të sigurohet se në sezonin pranveror në këtë fushë do të mund të zhvillohen ndeshjet futbolistike.





Së bashku me shefin e kabinetit Ali Morinë, si dhe me drejtorët Erhan Morinë dhe Albnor Mullabazin, kryetari takoi ministren e Ministrisë së Ekonomisë, znj. Artane Rizvanolli, ku patën rastin për të diskutuar bashkëpunimin ndërmjet ministrisë dhe komunës, rreth projektit për vendosjen e paneleve diellore (solare) për prodhimin e energjisë elektrike, përmes ankandit publik, i cili do të jetë i pari i kësaj natyre në Republikën e Kosovës.

Rahoveci do të jetë Komuna e parë në Kosovë që do ta ketë emrin "Smart City" me anë të projektit që do të zbatohet nga shërbimet e energjisë (ESCO) nga investitori sloven. Ky projekt është në funksion të digjitalizimit të shërbimeve, do të ketë shtrirje në infrastrukturën ekzistuese të ndriçimit publik dhe në vendbanimet në të cilat kemi planifikuar ta zgjerojmë ndriçimin publik. Përfitimet nga ky projekt do të jenë kryesisht në kursimet e energjisë elektrike, të cilat do të arrijnë deri në 2000 MWh/vit (MegaVat Orë për një vit).



Rahoveci po bëhet me Shesh Qendror përmes të cilit projekt synojmë që të kemi qasje në hapësira publike të sigurta, të shëndetshme dhe për të gjithë qytetarët, e në veçanti për fëmijët, të moshuarit dhe personat me nevoja të veçanta.

Kryetari Latifi priti në takim 8 përfitues, përpunues të pemëve dhe perimeve që i ka përkrahur (subvencionuar) nga thirrja e fundit e lëshuar nga drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm dhe Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në vlerë prej 28 mijë euro nga Komuna jonë. Përkrahja për përpunuesit e pemëve dhe perimeve do të jetë prioritet i yni edhe viteve në vazhdim, si dhe do të vazhdojmë përkrahjen konkrete edhe në fushëveprimtari të tjera ekonomike, si: zejtarët dhe artizanalet, bizneset e reja si dhe bizneset e vogla dhe të mesme, me qëllim të fuqizimit të tyre.



Në praninë e një numri të madh të qytetarëve, shoqërisë civile, kryetarëve të këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane, si dhe palëve të tjera të interesuara, kryetari Latifi ka paraqitur:

- Raportin e punës për vitin 2022;
- Planin e punës për vitin 2023;
- Listën e aktiviteteve të evidentuara gjatë këtij viti.
- Raportet e aktiviteteve thelbësore të secilës drejtori veç e veç - Ecuria e angazhimeve, investimeve, sukseseve dhe ngecjeve;
- Sfidat, detyrimet dhe përgjegjësitë dhe gjithë atë që ka ndodhur gjatë vitit 2022.

Kryetari Latifi, së bashku me drejtorin e DEZHT-së, Erhan Morina si dhe stafin e tij, morën pjesë në vënien e gurthemelit, të stacionit të autobusëve në Rahovec, ku do të bëhet ndërtimi i lokaleve afariste zejtare, i cili projekt do të kushtojë 84,879.12 €.





Në prani të shumë qytetarëve, kryetari ka përruar Çerdhen për Fëmijë në Xërxë, projekt ky i cili është realizuar me buxhetin e komunës sonë. Çerdhja për fëmijë në Xërxë, e ndërtuar sipas standardeve bashkëkohore tashmë është e gatshme me kushte shumë të mira infrastrukturore, mirëpo jemi në pritje të pajisjes me inventar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Në çerdhe mund të sistemohen deri në 80 fëmijë, nga mosha 9 muajsh deri në 5 vjeç.

Në sallën e Kuvendit Komunal, nën shoqërimin e nënkryetarit Iska, të drejtorit të administratës Besnik Hotit dhe drejtorëve të drejtorive komunale, kryetari mbajti takimin e katërt të rregullt periodik me punonjësit e administratës komunale, të cilët i falenderoi për angazhimet dhe bashkëpunimin në baza ditore në përputhje me detyrimet e parapara me ligj, si dhe theksoi edhe një herë rëndësinë e respektimit të orarit të punës dhe përkushtim të pazezervë në kryerjen e shërbimeve për qytetar.



Në bashkëpunim me Organizatën Ndërkombëtare për Migrim (IOM) dhe Komunës së Rahovecit, në Shkollën Fillore të Mesme të Ulët "Gëzim Hamza-Piktori" solemnisht është hapur Qendra Arsimore për Komunitete me bazë në Shkollë". Vlera totale e këtij projekti me bashkëfinancim ka shumë 20.357,00 €, ndërsa kontributi i komunës së Rahovecit është në vlerë prej 6.740,00 €.

Ilyetari Latifi, së bashku me bashkëpunëtorët e tij priti në takim punë Sëfin e Misionit të OSBE-së në Kosovë, Ambasadorin Michael Davenport, me të cilin biseduam lidhur me çështjet me interes të përbashkët si dhe format e vazhdimit të bashkëpunimit në mes të Komunës së Rahovecit dhe misionit të OSBE-së në Kosovë.



Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport, edhe këtë vit organizoi ceremoninë e zgjedhjes së laureatëve të sportit për vitin 2022 në komunën tonë. Sportistët që spikatën me rezultate të lakmueshme gjatë këtij viti, ishin:

Sportistja me prespektivë – Elma Sharku;
Sportisti me prespektivë – Sinan Kadiri;
Klubi i vitit 2022 – KH "Rahoveci",
Trajneri i vitit 2022 – Xhafer Bytyqi,
Gjyqtari i vitit 2022 – Taulant Haxhimustafa, Punëtori sportiv i vitit – Burim Dula, Veteran aktiv i sportit gjatë vitit 2022 – Bekim Cena, Veteran sportiv i vitit 2022 – Sadedin Cena dhe Sportisti i vitit 2022 u zgjodh – Kenan Haxhihamza.

Ka filluar puna në instalimin e ndriçimit publik në Vrajakë dhe Bratotin. Ndriçimi publik që do të instalohet është ndriçim smart me shërbimet ESCO, të cilat përmbajnë në vete edhe efektet e kursimit të energjisë.



PËRUNDIM

Edhe pse fusha e qeverisjes së mirë është mjaft e gjërë, një aspekt i rëndësishëm i saj që është i pashmangshëm për ta plasuar qytetarin në vend qendror është liria e informimit.

Informacioni është themeli i qeverisjes së mirë, jo vetëm sepse e rrit efikasitetin por gjithashtu sepse i fuqizon qytetarët dhe mundëson shpërndarje të barabartë të përfitimeve nga zhvillimi i përgjithshëm në vend, andaj duke dashur që të jetë sa më transparente me publikun, Komuna e Rahovecit, përmes këtij dokumenti ka ofruar një pasqyrë të përgjithshme të aktiviteteve të saj, për t'iu dhënë mundësi qytetarëve që të njohin e vlerësojnë punën e institucioneve komunale.

Në nivelin lokal, mekanizmi i pjesëmarrjes së qytetarëve në bërjen e politikave është kriter bazë i demokracisë së drejtpërdrejtë të cilin duhet respektuar njësitë e vetëqeverisjes lokale.

Komuna e Rahovecit ka vënë në funksion këto parime përmes formave të ndryshme të komunikimit me qytetarë, takimeve të drejtpërdrejta, informimit publik dhe çfarëdo metode tjetër përmes së cilës transparenca të ndikojë në avancimin e vetëqeverisjes lokale.

Përveç konsultimit dhe komunikimit, këto dokumente forcojnë lidhjet e qytetarëve me komunën dhe rrisin besimin që e gëzojnë zyrtarët publik në nivel lokal.

Rahovec, dhjetor 2022